



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Prijmljen / Prodato Received / Delivered	18.09.2023	viti god year	3
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	6143/2023		1/8



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1059/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1059/2023 të datës 04.08.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rr. [redacted], kundër Vendimit KA.nr.25/2023 të datës 06.07.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.09.2023, mori:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.25/2023 i datës 06.07.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- II. Anulohet Njoftimi për për zgjedhjen përfundimtare të datës 01.06.2023, Lista e ngushtë e kandidatëve duke përfshirë rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë si dhe Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni i Pranimit i datës 01.06.2023, ndërsa lënda kthehet në ri-shqyrtim dhe ri-vendosje.
- III. Obligohet Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të ndërmarr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të ri-zhvilloj procedurën e rekrutimit për pozitën "Referent" në Gjykatën Themelore të Gjakovës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.
- IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendimi.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 15.02.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm me Nr. 01/2023 për katër dhjetë e një pozita (41), ndërsa në Gjykatën Themelore në Gjakovë katër pozita (4) me titull pozitën e punës "Referent" në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi [REDAKTUAR] i cili është ftuar të marrë pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë mirëpo nuk është përzgjedhur si kandidatë i suksesshëm për asnjërën pozitë.

Më datën 01.06.2023 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka publikuar njoftimin për kandidatët e suksesshëm me numër protokoll 03/820 për pozitën "Referent" katër (4) në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

I pakënaqur me njoftimin e datës 01.06.2023, ankuesi më datë 29.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll Nr.01/947 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 06.07.2023 ka nxjerr Vendimin me numër KA.nr.25/2023 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit, me arsyetimin se përzgjedhja e kandidatëve për pozitën "Referent" në Gjykatën Themelore në Gjakovë është bërë konform nenit 40.1 të Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili parasheh: *Në Shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*", ku nga shkresat e lëndës del se të gjithë kandidatët e përzgjedhur kanë pasur në total pikë më tepër pikë se ankuesi, pas testit me shkrim dhe intervistës me gojë, dhe atë kandidatja e parë e përzgjedhur ka pasur 417.75 pikë, kandidati i dytë i përzgjedhur 402.25 pikë, kandidati i tretë i përzgjedhur 391 pikë, si dhe kandidatja e katërt e përzgjedhur 387.75 pikë, për dallim nga ankuesi i cili ka pasur 355 pikë andaj nuk ka arritur që të jetë njëri nga kandidatët fitues i përzgjedhur në këtë pozitë.

Në këtë mënyrë Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore ka nxjerr Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të datës 01.06.2023 lidhur me kandidatët e suksesshëm për pozitën e shpallur të konkursit nga ku rezulton se ankuesi nuk ishte kandidat i përzgjedhur.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KA.nr.25/2023 të datës 06.07.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 02.08.2023 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 04.08.2023 me numër protokoll 5536/2023 me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale të zbatimit të procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil neni 41 paragrafi 5 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar i Ligjit për Shërbimin Civil dhe të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 30.08.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokollin 5536/2023 të datës 04.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr.25/2023 me numër protokollin 01/967 të datës 06.07.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK; Njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare me numër protokollin 03/820 të datës 01.06.2023 të SKGJK-së; Njoftimi për rezultatet e testimit me shkrim me numër protokollin 03/694 të datës 11.05.2023 të SKGJK-së; Njoftim për testim me shkrim me numër protokollin 03/588 të datës 26.04.2023 të SKGJK-së; Shpalljen për Konkursin e Jashtëm me numër Nr.01/2023 të datës 15.02.2023 të SKGJK-së; Pliko me numër R5219064 i datës 02.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë të datës 16.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 30.08.2023; Propozim për emërimin e kandidatit të rekomanduar nga SKGJK i datës 01.06.2023; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni rekrutues i SKGJK-së të datës 01.06.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 01.06.2023; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e SKGJK-së e datës 01.06.2023; Përcaktimi i kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj të datës 13.04.2023; Testi me shkrim për pozitën "Referent"; Raport mbi përgatitjen e listës së ngushtë të SKGJK-së; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë të SKGJK-së të datës 25.04.2023; Deklaratat për mos ekzistimin e konfliktit të interesave të datës 28.04.2023 të anëtarëve të Komisionit të SKGJK-së; Regjistri i aplikacioneve të pranura në SKGJK-në; Vendim me numër protokollin 03/448 të datës 24.03.2023 të SKGJK-së; Propozimin për emërimin e KPSHC-së të datës 23.03.2023 të SKGJK-së; Vendimin me numër protokollin 01/135 të datës 09.02.2023 të KGJK-së; Udhëzues për testin me shkrim të datës 29.04.2023 të [redacted]; Pesë 5 vlerësimet e testit me shkrim të datës 29.04.2023 dhe testit me gojë të datës 18.05.2023 nga të gjithë anëtarët e komisionit për kandidatin [redacted]; Testi me shkrim për pozitën referent të kandidatit [redacted]; Kërkesë për punësim me numër 41 të datës 28.02.2023 të kandidatit [redacted] për pozitën referent në Gjykatën Themelore në Gjakovë; Diplomë me numër Nr.1005 të datës 08.10.2020 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë- Fakulteti Juridik për [redacted]; Referencë për [redacted] e datës 13.04.2022; Performancë për [redacted] e datës 30.04.2021 nga Av. [redacted]; Certifikatë nga Gjykata Themelore Gjakovë për [redacted] me numër A.GJ.I.nr.124/2022 të datës 12.04.2022; Kontratë pune e datës 01.07.2022 e lidhur mes [redacted] dhe Përmbarues Privat "Gjokë Radi" B.I"; Kontratë pune e datës 04.01.2023 e lidhur mes [redacted] dhe Përmbarues Privat "Gjokë Radi" B.I"; Kontratë pune e datës 01.09.2022 e lidhur mes [redacted] dhe Përmbarues Privat "Gjokë Radi" B.I"; Kontratë punë për kohë të caktuar të datës 01.07.2020 të lidhur mes "Suzana Daija" [redacted] dhe [redacted]; Certifikatë e muajit qershor 2022 të "Human Ngo" për [redacted]; Kontratë punë e datës 01.02.2021 e lidhur mes [redacted] dhe [redacted]; Kontratë e punës për kohë të caktuar të datës 01.02.2021 e lidhur mes "Suzana Daija" [redacted] dhe [redacted], Certifikatë mbi dënimet penale të datës 28.02.2023 për [redacted]; Kopjen e letërnjoftimit të [redacted]; Udhëzues për testin me shkrim të datës 29.04.2023 të [redacted]; Pesë (5) vlerësimet e testit me shkrim të datës 29.04.2023 dhe testit me gojë të datës 18.05.2023 nga të gjithë anëtarët e komisionit për kandidatin [redacted]; Testi me shkrim për pozitën referent të kandidatit [redacted]; Kërkesë për punësim me numër 10 të datës 23.02.2023 të kandidatit [redacted] për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Gjakovë; Diplomë me numër 1552/16 të datës 23.11.2016 të lëshuar nga Kolegji "AAB"-Juridik i Përgjithshëm për [redacted]; Certifikatë nga Gjykata Themelore Pejë për [redacted] me numër GJ.A.Nr.85/2018 të datës 01.02.2018; Vërtetim i datës 20.09.2018 të Përmbaruesit privat GJ.R. për [redacted]; Vërtetim i përvojës së punës të datës 05.05.2022 të "Signal Tech

Sh.P.K" për [redacted]; Referencën e datës 20.09.2018 të Përmbauesit Privat Gj.R. për [redacted]; Referencë për [redacted] e datës 05.10.2017; Certifikatë e datës 05.08.2020 nga IKT për [redacted]; Kopjen e letërnjoftimit të Udhëzues për testin me shkrim të datës 29.04.2023 të kandidatit [redacted]; Pesë (5) vlerësimet e testit me shkrim të datës 29.04.2023 dhe testit me gojë të datës 23.05.2023 nga anëtarët e komisionit për [redacted]; Testi me shkrim për pozitën referent të kandidatit [redacted]; Kërkesë për punësim të datës 01.03.2023 të kandidatit [redacted] për pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Gjakovë- Dega në Deçan; Kopjen e letërnjoftimit të [redacted]; Diplomë me numër 358 të datës 28.09.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"- Fakulteti Juridik për [redacted]; Vërtetim me numër 1157/2018 të datës 08.10.2018 të Odës së Avokatëve të Kosovës për [redacted]; Certifikatë mbi dënimet penale të datës 01.03.2023 për [redacted]; Kontratë për shërbime të datës 12.11.2019 të lidhur mes "YIHR" dhe [redacted]; Kontratë punësimi e datës 11.02.2020 e lidhur mes "Kosovo Women's Network" dhe [redacted] Kontratë e punës për shërbime të veçanta të datës 01.08.2021 të lidhur mes Iniciativës për Drejtësi dhe Barazi dhe [redacted]; Ankesi I Kontratën e punës për shërbime të veçanta të datës 01.11.2021 të lidhur mes Iniciativës për Drejtësi dhe Barazi dhe [redacted]; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 31.08.2021-01.06.2022 të [redacted]; Kontratë e shërbimeve të datës 01.07.2022 të lidhur mes GLPS dhe [redacted]; Marrëveshje konfidencialiteti; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 11.08.2022-15.11.2022 të [redacted]; Kontratë e punës e datës 07.11.2022 të lidhur mes "KEDS" dhe [redacted]; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 07.11.2022; Kontratë e punës e datës 07.02.2023 të lidhur mes "KEDS" dhe [redacted]; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 16.12.2022-16.02.2023 të [redacted]; Referencë e datës 11.02.2020 të Gjyqtarit M.SH për [redacted]; Letër referencën e datës 12.10.2020 të Rrjetit të Grave të Kosovës për [redacted]; Letër reference e datës 15.06.2022 nga "Inject" për [redacted]; Letër rekomandim nga [redacted] për [redacted]; Certifikatë e datës 02.05.2021 nga "Help" për [redacted]; Certifikatë e datës 07.04.2022 nga "Help" për [redacted]; Udhëzues për testin me shkrim të datës 29.04.2023 të kandidatës [redacted]; Pesë (5) vlerësimet e testit me shkrim të datës 29.04.2023 dhe testit me gojë të datës 17.05.2023 nga të gjithë anëtarët e komisionit për kandidaten [redacted]; Testi me shkrim për pozitën referent të kandidatës [redacted]; Kërkesë për punësim me numër 53 të datës 01.03.2023 të kandidatës [redacted] për pozitën referent në Gjykatën Themelore në Gjakovë; Marrëveshje për shërbime të veçanta me numër protokollit 03/2176 të datës 05.12.2022 të lidhur mes SKGJK-së dhe [redacted]; Vërtetim me numër Agj.II.06/23 të datës 01.03.2023 të Gjykatës Themelore në Gjakovë për [redacted]; Kontratë pune për kohë të pacaktuar të datës 01.03.2021 të lidhur mes "European Clinic Sh.P.K." për [redacted]; Kontratë pune për kohë të caktuar të datës 10.08.2020 të lidhur mes "European Clinic Sh.P.K" për [redacted] Kopjen e letërnjoftimit të [redacted]; Letër referencë nga "European Clinic" për [redacted]; Referencë për [redacted] e datës 28.02.2023; Vendim me numër reference 216/1625 të datës 12.02.2021 të MASH; Vendim me numër reference 216/1626 të datës 24.03.2021 të MASH; Vërtetim i kopjes nga origjinali me LRP.Nr.2479/2023; Vërtetim i kopjes nga origjinali me LRP.Nr.2480/2023; Diplomë me numër 15807 të datës 30.08.2016 nga Universiteti i Tiranës- Fakulteti i Drejtësisë për [redacted]; Diplomë me numër 2488 të datës 28.09.2018 të Universitetit të Tiranës- Fakulteti i Drejtësisë për [redacted]; Udhëzues për testin me shkrim të datës 29.04.2023 të kandidatës [redacted]; Testi me shkrim për pozitën referent të kandidatës [redacted]; Pesë (5) vlerësimet e testit me shkrim të datës 29.04.2023 dhe testit me gojë të datës 23.05.2023 nga anëtarët e komisionit për kandidaten [redacted]; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 14.09.2023; Kërkesë për punësim me numër 3 të datës 02.03.2023 të kandidatës [redacted] për pozitën referent në Gjykatën Themelore në Gjakovë; Diplomë me numër 474 të datës 20.09.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"-Fakulteti Juridik për [redacted]; Kontratë pune për periudhë të caktuar kohore me numër protokollit 3752 të datës 27.06.2022 të lidhur mes "Migros Group" dhe [redacted]; Kontratë pune për periudhë të caktuar kohore me numër protokollit 3387 të datës 05.01.2022 të lidhur mes "Migros Group" dhe [redacted]; Marrëveshje për punë praktike ndërmjet "Dexis" dhe [redacted] e datës 01.09.2022;

Kontratë pune për periudhë të caktuar kohore me numër protokolli 2774 të datës 23.07.2021 të lidhur mes "Migros Group" dhe [redacted]; Vërtetim i datës 01.07.2019 nga Kuvendi i të Rinjëve të Prizrenit për [redacted]; Letër rekomandimin e datës 25.02.2020 i Gjyqtarës [redacted] për [redacted]; Vërtetim i datës 24.02.2023 të "Migros Group" për [redacted]; Certifikatë e datës 28.02.2020 të Gjykatës Themelore në Prizren për [redacted]; Certifikatë mbi dënimet penale të datës 24.02.2023 për [redacted]; Certifikatë e muajit Janar 2018 të "DJ" për [redacted]; Certifikatë nga "KDI" për [redacted] e muajit Dhjetor 2019; Certifikatë nga "LDA Kosovo" për [redacted] e datës 16.05.2020; Certifikatë e muajit prill 2016 nga "USPE" për [redacted]; Certifikatë e datës 22.05.2020 nga "YIHR" për [redacted]; Certifikatë e datës 18.11.2017 nga "Ngo Vkbik" për [redacted]; Certifikatë e datës 17.10.2017 nga "ECD" për [redacted]; Certifikatë e datës 04.06.2020 nga "LDA" Ballkan për [redacted]; Certifikatë e datës 10.11.2022 nga "Loja" për [redacted]; Certifikatë e datës 15.05.2018 nga "KDI" për [redacted]; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 13.04.2021-14.02.2023 të [redacted]; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 13.09.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 13.09.2023; Ankesë e [redacted] me numër protokolli 01-947 të datës 29.06.2023 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK; Certifikatë mbi dënimet penale të datës 27.12.2022 për [redacted]; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 18.09.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 15.02.2023 me numër protokolli 03-249 ka shpallur konkursin e jashtëm me Nr: 01/2023 për katër dhjetë e një pozita (41), ndërsa në Gjykatën Themelore në Gjakovë katër pozita (4) me titull pozitën e punës "Referent" me koeficient shtatë (7), në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi [redacted] ku kanë qenë gjithsejtë dyqind e njëzet e tetë (228) kandidatë ndërsa testimi me shkrim ju kanë nënshtruar njëqind e shtatëdhjetë e tetë kandidat (178), ku ankuesi është ftuar të marrë pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë mirëpo nuk është përzgjedhur si kandidatë i suksesshëm për asnjërën pozitë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 15.02.2023 me numër protokolli 03-249 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit të pranimit (i jashtëm) për pozitën "Referent" në Gjykatën Themelore në Gjakovë me numër 01/2023, ndërsa bazuar në renditjen përfundimtare të kandidatëve konstatohet fakti se ankuesi ka arritur ti mbledh 355 pikë duke u renditur e dhjeti (10) në listë, rrjedhimisht nuk është përzgjedhur kandidat fitues.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin e shpallur të datës 15.02.2023 për pozitën "Referent" në Gjykatën Themelore të Gjakovës me numër 01/2023, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë: *Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulltetit Juridik e nevojshme. Së paku dy (2) vite përvojë pune e nevojshme.*

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me kërkesën e tij për anulimin e konkursit për shkak se kandidatët fitues janë favorizuar dhe se konkursi ka qenë i shoqëruar me parregullsi dhe se ka pas shkelje të dispozitave procedurale të zbatimit të procedurave

të rekrutimit në Shërbimin Civil neni 41 paragrafi 5 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar i Ligjit për Shërbimin Civil dhe të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se disa nga kandidatët e përzgjedhur nuk i kanë përmbushur kriterin e konkursit lidhur me përvojën e punës, rrjedhimisht Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit përmes Vendimit numër KA.nr.25/2023 të datës 06.07.2023 nuk ka arritur të arsyetojë mjaftueshëm aktin e nxjerrë nëse kandidatët e përzgjedhur kanë përmbushur kriterin e konkursit lidhur me përvojën e punës sipas konkursit të datës 15.02.2023, ndërsa theksojmë faktin se duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative arsyetimi i vendimit është detyrim ligjor, respektivisht arsyetimi jo plotë apo i mangët është i barabartë me mungesën e tij, gjegjësisht kjo çështje rregullohet me nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 ndërlidhur me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të njëjtit ligj.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton faktin se kandidati i përzgjedhur [redacted] përveç praktikes një vjeçare në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Deçan, përvojën e punës së fituar në institucione private nuk e ka dëshmuar me dokumentacionin e nevojshëm, respektivisht në kërkesën për punësim të datës 23.02.2023 nuk ka bashkangjitur ndonjë dokument përcjellës nga Trusti i Kursimeve Pensionale apo nga Administrata Tatimore Kosovës, sepse përvoja e punës në sektorin privat e provuar vetëm përmes shkresave të lëshuar nga punëdhënësi nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme nëse të njëjtat nuk janë të shoqëruara edhe me vërtetim nga organet përgjegjëse, po ashtu kandidatja e përzgjedhur [redacted] përveç Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta të datë 05.12.2022 dhe Vërtetimit nga Administratori i Gjykatës Themelore në Gjakovës të datës 01.03.2023 si Praktikante Vullnetare përvojën e punës së fituar në institucione private nuk e ka dëshmuar me dokumentacionin e nevojshëm, respektivisht në kërkesën për punësim të datës 01.03.2023 nuk ka bashkangjitur ndonjë dokument përcjellës nga Trusti i Kursimeve Pensionale apo nga Administrata Tatimore Kosovës, sepse përvoja e punës në sektorin privat e provuar vetëm përmes shkresave të lëshuar nga punëdhënësi nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme nëse të njëjtat nuk janë të shoqëruara edhe me vërtetim nga organet përgjegjëse kështu që lidhur me këtë Kolegji i Këshillit, ju ka referuar Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, e cila ka theksuar se dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmojnë me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës apo dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar edhe me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale. Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se as ankuesi në kërkesën për punësim të datës 28.02.2023 nuk ka bashkangjitur ndonjë dokument përcjellës nga Trusti i Kursimeve Pensionale apo nga Administrata Tatimore Kosovës, përveç praktikes një vjeçare në Gjykatën Themelore në Gjakovë, si dhe nga shkresat e lëshuara nga organi punëdhënës nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme nëse të njëjtat nuk janë të shoqëruara edhe me vërtetim nga organet përgjegjëse të lartcekura.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Përzgjedhës në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e përgatitjes së listës së shkurtër përmes të

cilës kandidatët e përzgjedhur dhe ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë, nuk ka arritur të dëshmojë apo arsyetojë në mënyrë plotë dhe të drejtë nëse të gjithë kandidatët në procedurë të plotë kushtet e konkursit gjegjësisht kualifikimin profesional atë të përvojës së punës, ashtu që i njëjti komision ka vepruar në kundërshtim me 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës"*, prandaj secili veprim i ndërmarrë procedural pas kësaj faze nga Komisioni Përzgjedhës duke përfshirë përpilimin e listës së ngushtë, rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë e deri te rekomandimi i Komisionit të Pranimit për kandidatët e suksesshëm janë të pavlefshme juridikisht dhe nuk mund të prodhojnë efekte juridike pasi që deri te ky rezultat ka ardhur si pasojë e një procedurë të përcjellë me shkelje të dispozitave të ligjit material dhe LPPA-së.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të pretendimeve ankimore të ankuesit për shkelje të parimeve të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe duke marrë parasysh dispozitatë të aplikuara ligjore në fuqi duke përfshirë konstatimet e shkeljeve të paraqitura si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se procedura e rekrutimit sipas konkursit me 01/2023 për pozitën *"Referent"* në Gjykatën Themelore të Gjakovës të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë deri në fazën e përfundimit për arsyet e dhëna si më lartë është zhvilluar në kundërshtim me dispozitatë e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nisur nga konstatimet e dhëna si më lartë ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.25/2023 i datës 06.07.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitatë e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.5/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, respektivisht sikurse përcaktohet në dispozitatë e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 11.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitatë që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"* i njëjtë është vendim i paligjshëm, prandaj është shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale të cekura si më lartë në këtë procedurë dhe me qëllim të eliminimit të tyre ka vendosur që të lëndën ta kthejë në rishqyrtim, ndërsa Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës obligohet të ndërmarrë veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të *ri-zhvillojë* procedurën e rekrutimit për pozitën *"Referent"*, në Gjykatën Themelore të Gjakovës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë dhe të bëjë rivlerësimin e të gjitha aplikacioneve të kandidatëve në këtë procedurë të rekrutimit, duke u bazuar në konstatimet dhe pikëpamjet e dhëna juridike si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, gjithëherë në respektim të normave të përcaktuara me dispozitatë e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1059/2023

Çlirim ZEKA


Procesmbajtës

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.